

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2


AMA sjell në Tiranë Platformën Europiane të Autoriteteve Rregullatore, 42 shtete pjesëmarrëse diskutojnë sfidat e tregut mediatik

Braathu vlerëson bashkëpunimin e AMA-s me platformat TikTok dhe X: Model për rregullatorët në Europën Juglindore



Fq. 2

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X




Fq. 2

AMA nis fushatën e Edukimit Mediatic në shkallë kombëtare, Krasniqi bashkëbisedon me gjimnazistët për sigurinë në mjedisin digjital


Me iniciativë të Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive...

Krasniqi prezanton regjistrin e transparencës së pronësisë së medias në Konferencën e 11-të Rajonale të Medias

Kryetarja e Autoritetit të Mediave mori pjesë në Konferencën e 11-të Rajonale të Medias në Europën Juglindore...



Fq. 2



Fq. 2

Kryetarja e AMA-s në Bukuresht, pjesë e Forumit të Komunikimeve Digjitale dhe Medias

Kryetarja e AMA-s mori pjesë në Forumin e Komunikimeve Digjitale dhe Medias, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Komunikimeve. Forumi u zhvillua në...

AMA sjell në Tiranë Platformën Evropiane të Autoriteteve Rregulatore, 42 shtete pjesëmarrëse diskutojnë sfidat e tregut mediatik

Nën organizimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive u zhvilluan në Tiranë punimet e konferencës së 63-të të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregulatore (EPRA), që është rrjeti më i vjetër dhe më i madh i rregullatorëve të medias në Europë. Në takim morën pjesë delegacione nga 42 vende të Europës të cilët diskutuan për sfidat e tregut mediatik. [Lexo më shumë](#)



Braathu vlerëson bashkëpunimin e AMA-s me platformat TikTok dhe X: Model për rregullatorët në Europën Juglindore

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim të rëndësishëm institucional me Ambasadorin Jan Braathu. Takimi u fokusua në rolin e OSBE-së si një nga partnerët strategjikë më të rëndësishëm të AMA-s në forcimin e standardeve demokratike. Ambasadori Braathu vlerësoi AMA-n duke e quajtur model të rregullatorëve në Europën Juglindore. [Lexo më shumë](#)



AMA nis fushatën e Edukimit Mediatic në shkollë kombëtare, Krasniqi bashkëbisedon me gjimnazistët për sigurinë në mjedisin digjital

Me iniciativë të Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka nisur një fushatë të re me shtrirje kombëtare, fokusuar te nxënësit e arsimit parauniversitar. Fushata që startoi nga Elbasani vijoi me gjimnazistët e Lezhës dhe do të shtrihet në të gjithë vendin. [Lexo më shumë](#)

Krasniqi prezanton regjistrin e transparencës së pronësisë së medias në Konferencën e 11-të Rajonale të Medias



Kryetarja e Autoritetit të Mediave mori pjesë në Konferencën e 11-të Rajonale të Medias në Europën Juglindore (SEEMC). Znj. Krasniqi tregoi punën e Autoritetit të Mediave Audiovizive në ndërtimin dhe publikimin e regjistrit të transparencës së pronësisë së medias audiovizive, një bazë të dhënash e plotë dhe e detajuar deri te përfutuesit fundorë dhe e aksesueshme në faqen zyrtare të AMA-s. [Lexo më shumë](#)




Kryetarja e AMA-s në Bukuresht, pjesë e Forumit të Komunikimeve Digjitalë dhe Medias

Kryetarja e AMA-s mori pjesë në Forumin e Komunikimeve Digjitalë dhe Medias, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Komunikimeve. Forumi u zhvillua në Parlamentin Rumun, në Bukuresht, me mikpritjen e Presidentit të ANCOM-it, Z. Valeriu Zgonea. [Lexo më shumë](#)

Konferenca rajonale për luftën kundër dezinformimit: Krasniqi prezanton në Podgoricë bashkëpunimin me TikTok e X

Në Podgoricë u zhvillua konferenca dyditore për Dezinformimin, Manipulimin dhe Ndërhyrjen e Informacionit të Huaj, organizuar nga Qendra e Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor. Në fjalën e saj, kryetarja e AMA-s prezantoi qasjen e AMA-s në mbrojtjen e publikut nga dezinformimi dhe eksperiencën e krijuar nga bashkëpunimi me platformat TikTok dhe X.

[Lexo më shumë](#)



Krasniqi mirëpret në AMA pjesëmarrësit e Programit Rajonal të Liderimit dhe Mobilitetit të të Rinjve

Kryetarja e AMA-s zhvilloi një takim me të rinj, kërkues, aktivistë dhe profesionistë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të mbledhur në Tiranë në kuadër të Programit Rajonal të Liderimit dhe Mobilitetit të të Rinjve, zbatuar nga SCiDEV. Znj. Krasniqi u ndal te rëndësia e edukimit mediatik, zhvillimet në tregun audioviziv, si dhe bashkëpunimet që AMA ka me platformat TikTok dhe X.

[Lexo më shumë](#)

